



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:015115

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01530754

P.nr.30/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit A. K., nga fshati S.i P./Vushtrri, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorit të shtetit PP.II.nr.99/2021 (2021:0003026) të datës 27.01.2021, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, më datë **04.02.2021**, merrë këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit PP.II.nr.99/2021, të datës 27.01.2021, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI: A.K., nga i ati Xh., i lindur më dt..., në fshatin S. .P./Vushtrri, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë 26.12.2020, rreth orës 16:48, në fshatin S.P./Vushtrri, i pandehuri me dashje i shkakton lëndim të lehtë trupor personit tjetër dhe atë të dëmtuarës B. B. në atë mënyrë që e dëmtuara kishte shkuar me një taxi në shtëpinë e të pandehurit në vendin e lartcekur për t'ia dërguar një fletore me shënime të cilat i kishte mbajtur për të kaluarën e tyre që kishte së bashku me të pandehurin për tri vite, posa ka shkuar tek dera ka dalur i pandehuri dhe ka filluar që ti bërtas e më pas e ka goditur me grushte dhe shuplakë dhe me dhunë e ka futur në automjetin taxi me të cilën e dëmtuara kishte shkuar deri aty me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konformë dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, dhe nenit 185 të KPRK-ës, si dhe nenit 450, dhe 495 të KPPK-ës,

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: A. K. i shqiptoon **DËNIM ME GJOBË** në shumën prej katërqind euro (400)€, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se të akuzuarit refuzojnë të paguajnë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarve për çdo 20€ (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1(një) ditë burgim.

Pala e dëmtuar B. B. udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP-II.nr.99/21 e datës 27.01.2021, ndaj të pandehurit A. K., nga fshati S. P./Vushtrri, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së,

Gjykatës i është kërkuar që kundër të akuzuarve të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohen të pandehurit A. K., ligjvënësi ka parashkruar dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vite.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konfrom nenit 493 dhe 494 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konfrom dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës: procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin A. K. me numër 2020-BD-910 e datës 26.12.2020 përshkrimi i rastit se si ka ndodhur ngjarja, procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitarin A. Sh. me numër 2020-BD-910 e datës 26.12.2020 përshkrimi i ngjarjes si dëshmitar derisa sa ka qenë duke punuar si Taxi e dëmtuara i ka kërkuar që ta dërgoje në fshatin S. aty ka ndodhur një mosmarrëveshje në mes të dëmtuarës dhe një burri i cili e kishte sulmuar të dëmtuarën, raporti i oficerit i datës 26.12.2020, raporti i spitalit Sheikh Zayed-Qendra Emergjente në Vushtrri për B. B. procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitarin B. B. me numër 2020-BD-910 i datës 29.12.2020, e cila e ka përshkruar rastin në ditën kritike se si ka ndodhur ngjarja dhe se si i pandehuri e ka sulmuar atë, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës për Berina Belegu, foto dokumentacioni (2) sosh.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata morri parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, meqë rast vepra është kryer me dashje nga ana e të pandehurit, intensitetin

e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-ës, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpësojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.30/21, datë: 03.02.2021

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.